



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 69, datë 12.06. 2020**

**“PËR**

**MIRATIMIN E PAGESËS SË QIRASË SIPAS VLERËS SË TREGUT TË LIRË, PËR  
FAMILJET E EVAKUARA NGA BANESAT E TYRE TË DËMTUARA NGA  
TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Aktit Normativ nr. 8, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”, miratuar me ligjin nr. 96/2019, nenit 26, të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, nenit 30 dhe nenit 42, pika 1, shkronjat “b” dhe “d”, të Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, nenit 21, pika 5, shkronja “b”, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë”, të ndryshuar, pikës 5, të Vendimit nr. 129, datë 03.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për pagesën e plotë të qirasë sipas vlerës së tregut për familjet që janë dëmtuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019”, Vendimit nr. 157, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e pagesës së plotë të qirasë, për një periudhë 1-vjecare, sipas vlerës së tregut të lirë, për familje, banesat e të cilave janë dëmtuar si rezultat i tërmetit të datës 26.11.2019, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Afati i pagesës së qirasë mujore për familjet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, fillon nga muaji Qershor 2020.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale të ndjekë të gjithë procesin dhe monitorojë pagesën e qirasë për familjet përfituese, si dhe të njoftojë strukturat përgjegjëse për ndërprerjen e kësaj pagese, në rast se këto familje sistemohen përfundimisht në një banesë, përpara afatit të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.
4. Familjet përfituese sipas këtij vendimi, përjashtohen nga pagesa e taksës së ndërtesës, në masën e parashikuar nga ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.
5. Efektet financiare sipas këtij vendimi, do të përballohen nga bonusi i strehimit, në Programin e Strehimit Social, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2020.
6. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R I**

**TONI GOGU**